



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.01.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3965/15, për z. Musa Dragaj, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Mitrovicës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Musa Dragaj, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Mitrovicës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Dragaj është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast z. Dragaj është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Dragaj, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të hequr dorë nga funksioni si person i autorizuar në biznesin e tij privat në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Dragaj ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/52/16), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat N.T.P “Kristal – Petrol”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

